



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 70

Prishtinë, më 11.5.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Salih Morina.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH me Arben Çitakun, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca, NDI-Shefki Kastrati, Ambasada Amerikane, dy ekspertët E. Surdulli dhe F. Selmani, zyrtar nga Habitati) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 8.5.2012,
3. Projektligji për Ndërtimin,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.5.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8.5.2012.

3. Projektligji për Ndërtimin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti dhe falënderoj të pranishmit duke filluar me shqyrtimin e Projektligjit. Komisioni shqyrtoi vërejtjet konkrete prej Nenit 6 deri tek Neni 14 duke konstatuar si vijon :

- për Nenin 7 nga eksperti Amerikan u konstatua se nuk ka nevojë të shtohen pjesëmarrësit tjerë në ndërtim ngase vetëm sa e ngarkojnë ligjin pa nevojë,
- duhet të ndryshohet termi “aplikuesi” me termin “mbajtësi i lejes”,
- te Neni 9 duhet të riformulohet titulli ngase duhet të ceket “mbrojtja e ligjshmërisë”, ose neni të ndahet në dy pjesë,
- te Neni 10 u konstatua që kodi i ndërtimit duhet të përmban sendet e specifikuese,
- Neni 11 u sugjerua të fshihet.

Kryetari i Komisionit caktoi takimin e radhës duke kërkuar nga ekspertët e komisionit të përmbledhin vërejtjet dhe të sugjerojnë vërejtjet konkrete për komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 16,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani